

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Studiuesi: Punonjësit e AI janë “realisht të frikësuar” për të ardhmen e njerëzimit - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/studiuesi-punonjesit-e-ai-jane-realisht-te-frikesuar-per-te-ardhmen-e-njerezimit/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 06:45:45 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 06:44:54 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	116fc1b043b2b9612facf10254291a8a8d4941083a0b99ea4f53493ad3cc4ce8
TEKSTI	5f363ab8dc81c30a2e2ec123e6e9e67002b3e0e915911a435b8aba9d13383aac
PAMJA	e5abf70b9328518e9930ee057e7e2fbafdc669f2a4ec2dde78d632f5a43a1c5

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e4a9e41fb926a5be012d123a9579cdad20ed4e4d871d3c4932eace8439b0edd2
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7f30966000672975708e7c492689d739f9d4667f12adc4270686e28ed502fc27
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e4a9e41fb926a5be012d123a9579cdad20ed4e4d871d3c4932eace8439b0edd2>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

SHBA Donald Trump Inteligjenca Artificiale Viti i ri shkollor Lufta në Iran

BOTA

Studiuesi: Punonjësit e AI janë “realisht të frikësuar” për të ardhmen e njerëzimit

14 Shtator 2026 | 08:44

Një studiues i Inteligjencës Artificiale (IA), i cili dha dorëheqjen nga kompania Anthropic, ka deklaruar për BBC se punonjësit e kësaj fushe janë “realisht të frikësuar” nga shpejtësia e zhvillimit të teknologjisë dhe pasojat që mund të ketë për njerëzimin.

“Besoj se nëse nuk ngadalësojmë ritmin aktual të përparimit, ekziston një mundësi e fortë që të gjithë të vdesim në një të ardhme të afërt”, tha Jacob Coxon, pas postimit të tij viral mbi rreziqet e IA-së.

Coxon, 27 vjeç, i cili më parë kishte punuar në OpenAI, theksoi se frika e stafit lidhet me ndjesinë e të qenit të “bllokuar në një garë” mes kompanive. Ai shtoi se kërkesat për rregullim janë të sinqerta, pasi punonjësit janë të shqetësuar për rezultatet e kësaj gare.

Shefi i Anthropic, Dario Amodei, ka bërë thirrje për ngadalësim të zhvillimit të IA-së, një ide që është mbështetur edhe nga Sam Altman (OpenAI) dhe Elon Musk (xAI), të cilët kërkojnë rregullim dhe monitorim të pavarur të modeleve. Amodei ka theksuar se zhvillimi i teknologjisë nuk vihet në dyshim, por rreziqet janë “serioze” dhe kërkojnë kohë për t’u adresuar nga kompanitë dhe qeveritë.

Coxon mirëpriti idenë e ngadalësimit, por paralajmëroi se duhet të koordinohet edhe me Kinën për të shmangur një “garë në shkallë ndërkombëtare”.

Pyetja më e vështirë për t’u përgjigjur, sipas Coxon, ishte se si do të dukej një apokalips i Inteligjencës Artificiale.

Një nga rreziqet e përmendura nga Amodei ishte mundësia e një tufe programesh automatike (bots) që do të vepronin si një superkompjuter dhe mund të merrnin nën kontroll internetin.

Coxon tha se ky skenar mund të bëhej realist brenda gjashtë muajve deri në një vit.

Në përgjigje të largimit të Coxon, një zëdhënës i Anthropic i tha BBC News: “Ne kemi qenë gjithmonë transparentë se IA do të sjellë si përfitime të mëdha, ashtu edhe rreziqe të paprecedenta. Për t’i adresuar këto rreziqe, ne vazhdojmë të ndërtojmë modele me disa nga masat mbrojtëse më të forta në industri”.

Zëdhënësi shtoi se kompania ka qenë pionier në studimin e mënyrës se si funksionojnë modelet e IA. Anthropic ishte e para që publikoi një kornizë për zbutjen e rreziqeve të zhvillimit të tyre dhe gjithashtu “teston agresivisht” modelet e saj, duke publikuar gjetjet për të ndihmuar në shpjegim dhe për të parandaluar incidente të “mas?nërmithies së IA-”.

LAJMI I FUNDIT

08:38 SHBA nis takimet e G20-ës në Houston për “bollëkun e energjisë” mes krizës globale të karburanteve

08:37 Lyhet me bojë të kuqe statuja e Charlie Kirk në selinë e Turning Point USA, autori ende i pa identifikuar

08:30 Viti i ri shkollor, Kumbaro: Do të jemi pranë jush bashkë me SHPËRNDARJEKUADRËN E MADHE TË ARSIMIT
ARTIKULLIN

08:29 Nis viti i ri shkollor, 340 mijë nxënës ulen në bankat e shkollës

08:24 Presidenti Begaj uron nxënësit për vitin e ri shkollor: E ardhmja është në duart tuaja, besoni te ëndrrat

08:19 Aksidenti i rëndë në Turqi, autobusi përfshihet nga flakët pas përplasjes. 2 viktimë dhe 8 të plagosur (VIDEO)

TESTIM

së”.

“Kjo punë është gjithashtu arsyeja pse ne besojmë se bota do të përfitonte nga adoptimi i një mënyre ligjore dhe të verifikueshme për të punuar së bashku në ritmin e publikimit të modeleve të fuqishme”, thanë ata.

Coxon tha se kolegët e tij kishin frikë se rreziku mund të shfaqej edhe brenda dy viteve të ardhshme.

Ai shtoi se stafi në kompanitë e IA-së “po planifikon çfarë të bëjë me jetën e tyre dhe po mendon për ndikimet e punës së tyre”, ndërsa disa “po marrin në konsideratë blerjen e tokës diku, sepse janë shumë të frikësuar nga paqëndrueshmëria si rezultat i përparimit të shpejtë të IA’së”.

“E kanë këtë mendim çdo ditë ndërsa punojnë me teknologjinë”, tha ai.

Megjithatë, Coxon shprehu edhe pak optimizëm për të ardhmen e IA’së, duke i thënë BBC? se se njerëzit që e studiojnë teknologjinë “me të vërtetë duan të shohin anën pozitive” të gjërave si “zgjidhja e sëmundjeve dhe përmirësimi i jetës së të gjithëve”.

Shumë të tjerë në industri kanë shprehur shqetësimet e tyre pas postimit të Coxon në rrjetet sociale, përfshirë shkencëtarin e Anthropic, Evan Hubinger.

“Ne me të vërtetë besojmë se IA mund të vrasë të gjithë njerëzit! Personalisht mendoj se ka mbi 10% gjasa brenda dekadës së ardhshme”, tha Hubinger.

Shkencëtari kompjuterik dhe fitues i Çmimit Nobel, Geoffrey Hinton, i njohur si “Kumbari i IA’së”, i tha BBC’së të premten se një mundësi 10% që IA të vriste të gjithë njerëzit “nuk është e paarsyeshme”.

Ndërkohë, Marc Warner, shefi ekzekutiv i kompanisë së sigurisë së IA Faculty, i tha BBC’së se ishte “jashtëzakonisht e vështirë të vendosësh një probabilitet” mbi mundësinë që IA të vriste të gjithë njerëzit.

“Por është e rëndësishme të pranojmë se këta njerëz janë shumë të sinqertë në atë që thonë”, shtoi ai, duke vënë në dukje se rreziqet e IA’së janë ngritur nga drejtuesit e disa kompanive të teknologjisë prej vitesh.

Ish?kryeministri britanik Rishi Sunak, i cili është këshilltar i paguar i Anthropic, shkroi në Sunday Times se edhe ai ishte i shqetësuar për rrezikun e IA’së ndaj njerëzimit, pavarësisht se përgjithësisht mbetet optimist.

Megjithatë, disa figura të industrisë kanë sugjeruar se komentet mbi rreziqet dhe fuqinë e IA’së mund të jenë të dizenuara për të gjeneruar jehonë.

Shefi ekzekutiv i platformës së IA Hugging Face, Clement Delangue, shkroi në rrjetet sociale: “Më falni, por të pyesësh Jacob [Coxon] për rrezikun e zhdukjes nga IA është si të pyesësh teknikun e kondicionerit për ndryshimet klimatike. Nuk them se është domosdoshmërisht e parëndësishme apo e gabuar, por le ta shohim në perspektivë”.

Pas publikimit të esesë së Amodeli, megjithatë, Delangue ofroi ndihmën e tij për të qenë pjesë e zgjidhjeve të mundshme që propozoi kreu i Anthropic.

Ndërkohë, shefi i Nvidia, Jensen Huang, diskutoi komentet e Coxon në një konferencë të organizuar nga banka e investimeve Goldman Sachs javën e kaluar, sipas disa pjesëmarrësve që folën për BBC. Ata thanë se Huang i hodhi poshtë si të pavërteta. Ai më parë kishte deklaruar se ideja se IA “do të sillte fundin e njerëzimit” ishte “një marrëzi e plotë”.

Edhe pse ai mund të ketë interes biznesi në një bum të IA’së, pasi Nvidia prodhon çipat që fuqizojnë sistemet e inteligjencës artificiale, komentet e tij pasqyrojnë një kundër reagim në rritje në Silicon Valley ndaj paralajmërimeve ekzistenciale nga stafi aktual dhe ish?punonjësit.

Kritikë të tjerë thonë se Anthropic po përpiqet të nxisë një shtytje rregulatore për të bllokuar konkurrencën, duke e lënë atë dhe OpenAI në një duopol.

Raportohet se Anthropic po përparon për një ofertë publike fillestare (IPO) potencialisht rekord në bursë, duke u lejuar njerëzve të blejnë aksione të kompanisë.

OpenAI, e cila së fundmi u vlerësua me 852 miliardë dollarë, pritej të bënte të njëjtën gjë, por Sam Altman tha të premten se kjo nuk do të ndodhë këtë vit, duke përmendur shqetësimet për sigurinë.

Shiko në:

| LAJME TË SUGJERUARA

BOTA

SHBA nis takimet e G20-ës në Houston për “bollëkun e energjisë” mes krizës globale të

karburanteve

Shtetet e Bashkuara të Amerikës nisin të hënën një sërë takimesh të G20-ës ku po diskutojnë për “bollëkun e energjisë”, edhe pse lufta e Presidentit...

08:38 | 14/09/2026

BOTA

Lyhet me bojë të kuqe statuja e Charlie Kirk në selinë e Turning Point USA, autori ende i pa identifikuar

Një statujë e aktivistit të krahut të djathtë Charlie Kirk u vandalizua në selinë e Turning Point USA në Phoenix të Arizonës. Statuja u gjet e lyer me...

08:37 | 14/09/2026

BOTA | EVROPA

Aksident i rëndë në Turqi, autobusi përfshihet nga flakët pas përplasjes. 2 viktima dhe 8 të plagosur (VIDEO)

Një aksident i rëndë është regjistruar në autostradën Veriore Marmara në Turqi ku një autobus që u përplas me barrierat e pagesës dhe më pas shpërtheu në flakë. Fatkeqësisht...

08:19 | 14/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakttoni

Punësimi

Follow Euronews on all platforms: